

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

P4

ZGJIDHJE

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 21.11.2021

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	10	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	5	
4. Problemi 4	15	
5. Problemi 5	7	
6. Problemi 6	5	
7. Problemi 7	8	
Total	100	

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 1,188.00 Euro përfshirë TVSH me normën e reduktuar , sa duhet te jete vlera e TVSH në këtë faturë?
 - a) 95.00 Euro;
 - b) 88.00 Euro;**
 - c) 213.84 Euro;
 - d) 181. 23 Euro.

2. Kompania Soft në muajin Shtator 2021 ka pranuar një notë krediti nga furnitori. Vlera e TVSH-se ne ketë note krediti është 400 Euro. Kjo not krediti do të ketë ndikim ne deklaratën e TVSH-se për muajin Shtator 2021
 - a) 400.00Euro rritja e TVSh -së të llogaritur;**
 - b) 400.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;
 - c) 400.00 Euro zvogëlim të TVSH-se se llogaritur
 - d) 800.00 Euro zvogëlim te TVSH-se të zbritshëm.

3. Jeta Mala për vitin 2020 ka realizuar te ardhura bruto nga pagat prej 7,200.00 Euro. Sa janë obligimet tatimore për këtë vit pas çfarëdo zbritje te lejuar:
 - a) 720.00 Euro;
 - b) 684.00 Euro;
 - c) 317.60 Euro;
 - d) 417.60 Euro.**

4. Jeta Mala për vitin 2020 ka realizuar te ardhura bruto nga pagat prej 7,200.00 Euro. Sa është shuma e kontributit pensional të detyruar i punëdhënësve dhe i të punësuarit për këtë vit:
- a) 360.00 Euro;
 - b) 417.60 Euro;
 - c) 720.00 Euro;
 - d) 680.00 Euro.
5. Një shoqëri tregtarë si SHPK është i detyruar te kalkulojë obligimin tatimore për “Tatimin Mbi te Ardhurat e Korporatave” mbi bazën e te ardhurave reale gjegjësisht fitmit real kur ka arrit qarkullimin bruto për vit:
- a) Mbi 30,000.00 Euro;
 - b) Mbi 100,000.00 Euro;
 - c) 50,000.00 Euro;
 - d) Sipas vendimit të vet kompanisë.
6. Një biznes individual mundet te regjistrohet për TVSH në mënyrë vullnetarë dhe të behet person i tatueshëm kur ka arrit qarkullimin bruto për vit:
- a) Mbi 50,000.00 Euro;
 - b) Mbi 30,000.00 Euro;
 - c) Sipas vendimit të ATK ;
 - d) Sipas vendimit të biznesit .

7. Kontributet ne forme te donacionit për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit sipas ligjit Per Tatimin ne te Ardhurate Korporatave konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej: dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribute dhëna nga tatimpaguesit në fushën e sportit llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri ne 30% te fitimi;
 - b) Deri ne 10% te ardhurave te tatueshme;**
 - c) Deri ne 10% te tatimit ;
 - d) Deri ne 30% te tatimit.
8. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e kulturës dhe rinisë llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri ne 20% te fitimi;
 - b) Deri ne 10% te fitimit;
 - c) Deri ne 20% te tatimit ;**
 - d) Deri ne 30% te tatimit.
9. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore për pasurit e prekshme ne grupin e trete sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore është e me shkallen:
- a) Pesë përqind (5%);
 - b) Njëzet përqind (20%);;
 - c) Dhjetë përqind (10%). ;**
 - d) Ne varësi te llojit të asetit.

10. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore për pasurit e prekshme ne grupin e pare sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore është e me shkallen:

- a) Pesë përqind (5%);
- b) Njëzet përqind (20%);;
- c) Dhjetë përqind (10%). ;
- d) Ne varësi te llojit të asetit.

1. **Shoqëri Tregtare** - është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjin në fuqi Për Shoqëritë Tregtare, zyra e regjistrimit te bizneseve duhet të mbajë kopjet origjinale në letër të të dhënave për së paku 5 vite.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjin në fuqi Për Shoqëritë Tregtare, një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual.

E saktë

E pasaktë

4. Ortakët e Përgjithshëm të Ortakërisë së Përgjithshme janë vetëm personat fizik.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, mikro-ndërmarrjet janë ndërmarrje të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e së paku dy(2) nga kriteret e mëposhtme:

2.1. pasqyra e pozitës financiare prej treqind e pesëdhjetë mijë euro (350,000.00 €); 2.2. qarkullimi neto prej shtatë qind mijë euro (700,000.00 €) ; dhe

2.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: dhjetë (10)

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, përgatitja e pasqyrave financiare për ndërmarrjet e mesme behet sipas SNRF për NVM të plota..

E saktë

E pasaktë

7. Shoqëritë tregtare në Kosovë emërojnë një auditor apo një firmë të auditimit për angazhim fillestar të paktën për një vit. Angazhimi mund të rinovohet. As angazhimi fillestar i një auditori ligjor apo firme të auditimit, e as ky kombinim me ndonjë angazhim të përtërirë nuk duhet të tejkalojë kohëzgjatjen maksimale prej pesë (5) vitesh.

E saktë

E pasaktë

8. Pas skadimit të kohëzgjatjes maksimale të angazhimeve të një auditor apo një firmë të auditimit, auditori dhe firma e auditimit nuk do të ndërmarrë auditimin e përcaktuar me Ligj në të njëjtën njësi ekonomike brenda katër (4) viteve të periudhës vijuese.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, , të gjitha tatimet duhet të vlerësohen **brenda katër viteve** nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë obligues, apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një person i cili kundërshton vlerësimin e tatimeve ose përcaktim zyrtar të ATK mund të paraqesë ankesë në Departamentin e Ankesave për të ri-shqyrtuar përcaktimin zyrtar. Ankesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin e vlerësimit ose përcaktim tjetër zyrtar.

E saktë

E pasaktë

11. Çdo tatimpagues, pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet të kryejë regjistrim të mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimi i tillë, duhet të përfundohet më, apo para, 10 Janrit të vitit në vijim dhe të jetë në dispozicion për inspektim me kërkesën e ATK-së.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale , pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori janë të ardhura të përjashtuar nga tatimi.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, tatimpagues janë të gjitha shoqëritë tregtare te përcaktuara sipas “Ligjit Për Shoqëritë Tregtare”.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit janë te ardhura të përjashtuara nga tatimi.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit te TVSh-se, shfrytëzimi i mallrave për biznes si mostra apo dhurata me vlerë të vogël, nuk duhet të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit te TVSH-se, vendi i furnizimit të shërbimeve që behet nga një personin i tatueshëm ne Itali për personin e tatueshëm ne Kosove, është Kosova.

E saktë

E pasaktë

18. Në rastet kur rrogat për orar të plotë, qoftë të paguara në natyrë ose ndryshe, janë më të vogla se Paga Minimale, punëdhënësi i paguan pesë përqind (5%) të rrogës minimale dhe punonjësi paguan pesë përqind (5%) të rrogës së tij ose të saj për orar të plotë pune për kontribute pensionale.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, kontrata e punës mundet te nënshkruhet vetëm per një periudhe te pacaktuar.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, suspendimi i të punësuarit nga vendi i punës me ose pa pagesë, në përputhje me këtë ligj nuk konsiderohet si ndërprerje e marrëdhënies së punës,

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

F&B sh.p.k. regjistroi blerje gjate Tetorit 2021 ne shumën Euro 17,200 me normë standarde ; blerje me normën e reduktuar Euro 10,000; shitjet vendore me normën standarde Euro 65,000; eksportet Eur 8 000; shitje te përjashtuara pa te drejt kreditimi Euro 35 000 (Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne).

Deklarimet mujore për këtë vite janë bere duke shfrytëzuar koeficientin e vitit 2020 që ishte 70%.

Kërkohet:

- Sa është vlera e TVSH-se se zbritshëm për këtë muaj?
- Sa është vlera e TVSH-se se llogaritur për këtë muaj?
- Sa është vlera e TVSH-se se pagueshme për këtë muaj?

Zgjidhje

a) $17,200 \times 18\% = 3,096.00$
 $10,000 \times 8\% = 800.00$
 $3,096.00 \times 70\% = 2,167.20$
 $800.00 \times 70\% = 560.00$
Totali = 2,167.20 + 560.00 = 2,727.20

b) $65,000 \times 18\% = 11,700$
Exp 8,000
SHP 35,000
TOTAL = 11,700

c) $TVSH \text{ e pag} = TVSH \text{ e llogaritur} - TVSH \text{ e zbritshem}$
 $= 11,700 - 2,727.20 = 8,972.80$

Problemi 2

10 pikë

Kompania ndërtimore B&B Sh.A ka filluar projektin me ndërtim të larte që do të zgjat tre (3) vite. Bazuar ne përlogaritjet fillestare kompania planifikon të ardhura në tërësi nga projekti 10,000,000 euro dhe një kosto e tërësishme 6,000,000 euro.

Gjate viti të II- Kompania realizoj inkasimin e keshit nga marrëveshjet e shitjeve në vlere prej 2,800 000 Eur.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor për këtë vit sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, gjegjësisht trajtimi i kontratave afatgjata sipas këtij ligji.

Zgjidhje

Te ardhurat e parashikuara	10,000,000.00
Kosto e planifikuar	6,000,000.00
Fitimi I planifikuar	4,000,000.00
Tatimi I planifikuar	400,000.00
Koha e perfundimit te kontrates	3 vite

	Te ardhurat vjetore	Kostoja sipas koeficientit
Ne vitin II	2,800,000.00	0.28

*Koeficienti per vitin e dyte 28.00

Te ardhurat e tatushme **2,800,000.00**

Kosto 1,680,000.00

F.para tat 1,120,000.00

Tatimi 112,000.00

*Koeficienti per vitin e dyte $2,800,000 / 12,000,000 \times 100$

Problemi 3

5 pikë

Kompania STAR SHPK me 31 Dhjetor 2020 kishte këtë rezultat afarist:
Te ardhurat e përgjithshme 280,000 eur si dhe shpenzimet e përgjithshme 182,000 eur.

Në kuadër të te ardhurave të përgjithshme janë të përfshira edhe të ardhurat e interesit nga instrumentet e letrave me vlere të qeverise se Kosovës në vlere prej 8,000 eur. Po ashtu në shpenzimet e përgjithshme janë përfshire shpenzimet e donacionit në fushën e edukimit ne vlere prej 3,500 eur si dhe sponsorizimet në fushën e sportit ne vlere prej 4,000 eur.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor për këtë vit sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, duke i bere rregullimet e nevojshme sipas kërkesave ligjore.

Zgjidhje

Të ardhurat e përgjithshme	280,000
Shpenzimet e përgjithshme	182,000
<hr/>	
FITIMI para rregullimeve	98,000
Rregullimet	
Të ardhurat nga interesi	-8000
Shpenzimet e donacionit	3500
Sponsorizimi	4000
Fitimi para donacionit	97,500
*Donacioni	-3500

Fitimi	94,000
**Tatimi ne fitim	-6,580
***Sponsorizimi	-2820
Fitimi NETO	84,600

*** Donacion ne fushën e edukimit
bazuar ne**

Ligji Për Tatimin në të Ardhurat e

Korporatave neni 11 lejohen si

shpenzim deri 10% e te ardhurave te tatueshëm para se te jete llogaritur ky shpenzim.

$$94,000 * 10\% = 9,400-$$

****Tatimi ne fitim**

$$30\% = 6580$$

Ligji për sponsorizime I cili pranohet në nenin 11 pika 1.1 te Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave lejohet 30% e tatimit si shpenzim sponsorizimi

*****Sponsorizimi** sipas ligjit nr. Nr. 05/L -090 për Sponsorizime lejohet 30% e tatimi për sponsorizimin e sportit.

Problemi 4

15 pikë

Kompania ELAN shpk me seli në Prizren kryen aktivitete ekonomike tregtare në tërë territorin e Kosovës. Gjatë muajit Shtator 2021 ka pasur këto transaksione:

- i. shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatueshme 80,000 Euro;
- ii. shitjet brenda vendit me norme 8% - shuma e tatueshëm 10,000 Euro
- iii. shpenzime për shërbime konsulentë te pranuar nga kompania vendore 2,000 Euro;
- iv. importe nga jashtë (mallra për qëllime tregtimi) në vlerë 16,000 Euro, plus taksa doganore 10%/ (I takojnë normës standarde);
- v. importe nga jashtë (mallra për qëllime tregtimi) në vlerë 5,000 Euro, plus taksa doganore 10%/ (I takojnë normës së reduktuar);
- vi. shpenzimet e derivateve për vetura dhe kamion (të gjitha janë mjete pune) 3,000 Euro;
- vii. import i një veture transportuese i cili nevojitet për shpërndarjen e mallit në vlere 20,000 Euro, shtese 500 euro akcizë;
- viii. shpenzime për paga 6,000 euro;
- ix, shpenzime të qirasë 2,000 euro (nga një person i tatueshëm);
- ix. notë kreditore e pranuar me norme 18% ,vlera 800 Euro shuma e tatueshme;
- x. notë debitore e leshuar me norme 8%, vlera 300 Euro shuma e tatueshme;
- xi. shpenzime të rrymës dhe ujit të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar prej 2000 Euro (shuma e tatueshme), të gjitha në emër të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime konsulence nga personi i tatueshëm nga jashtë vendit në vlerë prej 1,000Euro (ngarkesë e kundërt për shërbime).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 09/2021.

Zgjidhje

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH2021

Periudha e Deklarimit: .09/2021
 Numri fiskal 800111222
 Emri I biznesit ELAN
 SH.P.K
 Elon
 Emri I personit kontaktues Pasha

		Furnizimet		
Shitjet e liruara pa te drejtë kreditimi	[9]			
Shitjet e liruara me drejtë kreditimi	[10]			
Eksportet	[11]			TVSH e llog
Shitjet e tatushme me normën 18%	[12]	80,000	[13]	14,400.00
Shitjet e tatushme me normën 8%	[14]	10,000	[15]	800.00
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]	4,444.45	[17]	800.00
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me norme 8%	[18]	3750	[19]	300
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 18%	[20]		[21]	
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 8%	[22]		[23]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]	
Blerjet qe I nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	1000	[29]	180.00
			[30]	16,480.00
		Blerjet		Totali I TVSH së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]			
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]			
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]			
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]			Tvsh e zbrit

Importet me normë 18%	[35]	17,600.00	[36]	3,168.00
Importet me normë 8%	[37]	5,500.00	[38]	440.00
Importet investive me normë 18%	[39]	20,500.00	[40]	3,690.00
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]	
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	7,000.00	[44]	1,260.00
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	2,000.00	[46]	160
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]		[48]	
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]	
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]	
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]	2000	[54]	360
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]	1000	[56]	80
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]		[58]	
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]	
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	1000	[66]	180
			[67]	9,338.00
		Kalkulimi		Totali I TVSH së Zbr
Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji I kaluar Balanca kreditore e mbetur	[68]			
$69=((67+68)-30)>0$	[69]			
Kërkesa për rimbursim	[70]			
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues $71=(69-70)$	[71]			
TVSH që duhet te paguhet $72=(30-67-68)>0$	[72]	7,142.00		

	Vlera	Norma doganore	taksa dog,	Akciza	Baza per TVSh
35	16000	10%	1600		17600
37	5000	10%	500		5500
39	20,000		0	500	20500
			shpenz		
	Kosulence	qiraja	deri		
43	2000	3000	2000		7000
	TVSH	Noram	Baza per TVSH		
16	800	18%	4,444.44		
18	300	8%	3,750.00		

Problemi 5

7 pikë

Kompania METRI sh.p.k. ka pranuar njoftim vlerësimi tatimor nga ATK me datë 15.Korrik 2021 për TVSH për periudhën 05/2020. Në baze këtij njoftim vlerësimi rezultoi me tatim shtesë prej 22,300 eur i cili ndryshim është me i madh se 10% e tatimit të paguar nga kompania për të njëjtën periudhë. Kompania deklaroj me 26 Qershor 2020 dhe beri pagesën në këtë datë.

Sa janë gjordat dhe interesi për këtë tatim shtesë që kompania do të paguaj bazuar në përlllogaritjen që parasheh Ligji mbi procedurat dhe Administratën Tatimore?

Zgjidhje

1. Ndëshkim për nëndeklarim tatimore 25%	22,300
*25% = 5,575.00	
2.Gjorda për mos dorëzim të deklaratës në kohë 5% në muaj (1 muaj)	22,300 *
5% = 1,115.00	
3. Gjorda për mos pagesë në kohë 1% muaj (12muaj max)	22,300 *
12%= 2,676.00	
4..Interesi 0.65% në muaj (14 muaj)	22,300 *
9.10% = 2.029.30	
TOTALI	11,395.30

Problemi 6

5 pike

Kompania KOBRA Sh.p.k me 31 Dhjetor 2020 kishte gjendje te aseteve si me poshte:

Kostoja ne eur

Toke - 300,000

Ndërtesa - 480,000

Kamion- 55,000

Buldozeri- 52,200

Makineri te renda per uzinen prodhuese - 320,000

Te gjitha asetet jane blere pare ketij viti, si dhe kane vlere te mbeture ne libra per zhvleresim te plote.

Kërkohet:

Përllogariteni zhvlerësimin tatimor për secilin aset sipas grupeve.

Zgjidhje

Zhvlerësimi Tatimor

TOKA - nuk zhvlerësohet

Grupi I

Ndërtesa - $480,000 \times 5\% = 24,000$

Grupi II

Kamion - $55,000 \times 20\% = 11,000$

Buldozeri- $52,200 \times 20\% = 10,400$

Grupi III

Makine Prodhimi - $320,000 \times 10\% = 32,000$

Totali

77,400

Problemi 7

8 pike

Ne muajin Shtator 2021 kompania MARS kishte listën e pagave si me poshtë me pagat bruto përkatëse:

1. Drejtori - 1,200 eur
2. Menaxher 1- 800 eur
3. Menaxheri 2 - 800 eur (banor jo i Kosovës)
4. Katër (4) zyrtare me page për një zyrtare-500 eur
5. Dy persona të angazhuar me pune të përkohshme si sekondare për një pagë- 400 eur

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga qe duhet mbajtur ne burim për muajin Shtator 2021 si dhe detyrimin për kontribute Pensionale.

Zgjidhja

	Paga bruto	KP I pun	Kp.Biz.	Paga e tatush	TAP	Paga Neto
Drejtori	1200	60	60	1140	91.8	1048.2
Menaxheri	800	40	40	760	53.8	706.2
*Menaxheri jo rezident	800			800	57.8	742.2
Menaxheri jo rezident	800			800	57.8	742.2
Zyrtar 1	500	25	25	475	25.3	449.7
Zyrtar 2	500	25	25	475	25.3	449.7
Zyrtar 3	500	25	25	475	25.3	449.7
Zyrtar 4	500	25	25	475	25.3	449.7
**Stafi sekondar 1	400	20	20	380	38	342
Stafi sekondar 2	400	20	20	380	38	342

TOTAL	6,400.00	240.00	240.00	6,160.00	438.40	5,721.60
-------	----------	--------	--------	----------	--------	----------

Sipa Shkalleve	Baza	Norma	Tatimi
0-80	0		
80-250	170	4%	6.8
250-450	200	8%	16
450-1140	25	10%	2.5
			25.3

*Menaxheri jo rezident - jo rezidentet nuk kanë obligim për kontribute pensionale.

** Stafi sekondar i kalkulohet TAP me shkallen max 10%.